

Sa po zbatohet Ligji i ri për shtetësinë e Maqedonisë së Veriut për shtetasit e ish-Jugosllavisë (neni 7)?

Hyrje

Pas shpërbërjes së Jugosllavisë dhe me shpalljen e pavarësisë së atëhere Republikës së Maqedonisë më 8 shtator 1991, mijëra qytetarë që jetonin në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut e humbën shtetësinë e tyre dhe fitimi i shtetësisë së shtetit të ri u bë shumë i vështirë, e për disa prej tyre edhe mision i pamundur.

30 vite pas shpalljes së pavarësisë së Maqedonisë së Veriut, Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa vendosën në procedurë parlamentare projektligj për ndryshimin e Ligjit për shtetësinë, me synim të zgjidhjes, ndër tjera, të pashtetësisë të shtetasit e ish-Jugosllavisë që kishin jetuar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut deri në shpalljen e pavarësisë. Pas tensioneve të shumta në Kuvend që u shkaktuan nga opozita maqedonase e cila vlerësonte këto ndryshime si antikushtetuese, ndryshimi i Ligjit për shtetësinë kaloi me procedurë të shkurtuar, me flamur evropian, më 29 korrik 2021.

Ligji për shtetësinë në Republikës e Maqedonisë së Veriut, ndër vite ka ndryshuar disa herë, mirëpo gjithnjë duke u vështirësuar kushtet. Ligji i vjetër përmbante kushte të cilat shumica e qytetarëve pa shtetësi nuk kanë mundur t'i plotësojnë. Kështu, shumë prej tyre kanë qëndruar me dekada pa shtetësi, duke u lënë nën hije në vendin ku ato jetojnë, punojnë dhe veprojnë.



Neni 7 i Ligjit të ri për shtësinë e Maqedonisë së Veriut (Gazeta zyrtare e RMV-së nr.174/2021 nga 30.07.2021) tani parasheh marrjen e shtetësisë me automatizëm për shtetasit e ish-Jugosllavisë nëse ata, bashkë me aplikimin e tyre, dorëzojnë një nga 16 dokumentet e përcaktuara me ligj që dëshmojnë se deri në kohën e shpalljes së pavarësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, kanë jetuar në territorin e vendit.¹

Në procedurën për marrjen e shtetësisë së Maqedonisë së Veriut në pajtim me nenin 7 të Ligjit për shtetësinë nuk është i nevojshëm opinioni i Agjencisë për Siguri Nacionale.

Sa po zbatohet procedura e nenit 7 të Ligjit të ri për shtetësinë ?

¹ 1) certifikatë nga libri amzë i të lindurve; 2) dëshmi për mbarimin e vitit shkollor (dëftesë, vërtetim ose diplomë); 3) dëshmi për marrëdhënie të themeluar të punës me formular M1/M2; 4) librezë pune; 5) dëshmi për tatim të paguar në pajtim me rregullativat ligjore, të cilat në atë periudhë kanë qenë në fuqi në Republikën e Maqedonisë, përkatësisht dëshmi se ka paguar: - tatim mbi të ardhurat personale të punëtorëve; - tatim mbi të ardhurat personale për kryerjen e veprimtarisë bujqësore; -tatim mbi të ardhurat personale nga kryerja e pavarur e veprimtarisë ekonomike dhe profesionale; -tatim nga kompensimi nga të drejtat autoriale, patentave dhe avancimeve teknike; - tatim mbi të ardhurat nga prona dhe të drejtat pronësore; - tatim mbi pronën dhe - tatimi mbi trashëgimi dhe dhuratë; 6) vendim të obliguesit tatimor nga Drejtoria e të Ardhurave Publike; 7)

Në një pyetje parlamentare të dorëzuar më 07 tetor 2022 nga Deputeti Halil Snopçe (Aleanca për Shqiptarët), në bashkëpunim me Institutin për Politika Publike Arbën Xhaferi, Kryeministri Dimitri Kovačevski ka njoftuar se sipas procedurës së nenit 7 të Ligjit për shtetësi, gjatë periudhës mars 2021 – tetor 2022, janë parashtruar gjithsej 697 kërkesa për marrjen e shtetësisë dhe se:

- 347 persona kanë fituar shtetësinë;
- asnjë aplikues nuk ka marrë përgjigje negative;
- për 350 persona, procedura për marrjen e shtetësisë është në rrjedhë e sipër.

Pra, më tepër aplikime ende nuk janë trajtuar (50,2%) sesa që janë miratuar (49,8%) nga Ministria e Punëve të Brendshme (figura 1).

dëshmi për llogari të paguar për shërbimet në vijim: - energji elektrike, - ngrohje, - ujë, -shërbime telefonike; 8) dokument udhëtimi (pasaportë) të lëshuar nga ish- RSFJ ose RM; 9) letërnjoftim të lëshuar nga ish-RSFJ ose RM; 10) letërnjoftim për të huaj; 11) librezë shëndetësore; 12) raport, vërtetim, fletëlëshim ose dokument tjetër me të cilin dëshmohet mjekimi i bërë në institucione publike shëndetësore në Republikën e Maqedonisë; 13) aktzotërim ose aktronësi në emër të kërkuesit; 14) librezë e kursimit për deponimin e kursimeve në bankë (person juridik) të themeluar nga Republika e Maqedonisë, në pajtim me ligjin; 15) dëshmi tjera të lëshuara nga organet kompetente shtetërore me të cilat do të vërtetohet vendbanimi i përhershëm në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe 16) dëftesat të cilët janë lëshuar nga viti 1991 deri 1998 për personat e lindur nga viti 1984 deri në vitin 1991.






Figura 1: Aplikimet për shtetësi sipas procedurës së nenit 7 të Ligjit për shtetësinë, të pranuar dhe të trajtuara në periudhën mars 2021 – tetor 2022

Sa i përket 350 aplikimeve që ende janë në procedurë dhe nuk kanë marrë përgjigje nga Ministria e Punëve të Brendshme, ato ventilohehen si në vijim sipas muajit të aplikimit:

Muaji i aplikimit (2021)	Numri i aplikimeve	Muaji i aplikimit (2022)	Numri i aplikimeve
mars 2021	1	janar 2022	41
prill 2021	1	shkurt 2022	27
gusht 2021	4	mars 2022	40
shtator 2021	44	prill 2022	19
tetor 2021	58	maj 2022	16
nëntor 2021	43	qershor 2022	14
dhjetor 2021	27	korrik 2022	2
		gusht 2022	1
		shtator 2022	6
		tetor 2022	6
Totali 2021	178	Totali 2022	172

Pra, ajo që vie nga dukje nga këto numra është se është krijuar një numër i madh i lëndëve të prapambetura, kryesisht në periudhën e menjëhershme pas miratimit të ligjit të ri për shtetësinë (figura 2).




Figura 2: Aplikimet për shtetësi sipas procedurës së nenit 7 të Ligjit për shtetësinë të patrajtuara, sipas muajit të aplikimit

Pjesa më e madhe e lëndëve të prapambetura janë të vjetra nga 10-12 muaj me 31,7% i totalit të lëndëve të patrajtuara, pasuar nga lëndët të vjetra nga 12-15 muaj me 30,3% dhe lëndët të vjetra nga 7-9 muaj me 24,6% (figura 3).




Figura 3: Aplikimet për shtetësi sipas procedurës së nenit 7 të Ligjit për shtetësinë, sipas vjetërsisë së lëndës

Në vend të konkluzionit

Ky buletin politik trajton vetëm procedurën për marrjen e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në sipas procedurës së nenit 7 të Ligjit për shtetësinë i cili ka të bëjë me qytetarët pa shtetësi të cilët jetonin në territorin e vendit deri me shpalljen e pavarësisë më 8 shtator 1991, të atëhere Republikës së Maqedonisë.

Aplikimet për fitim të shtetësisë sipas procedurave tjera, siç janë marrja e shtetësisë me origjinë ose me natyralizim, nuk janë pjesë e këtij buletini por ato do të adresohen në buletine të radhës në bazë të pyetjeve të mëtejme parlamentare dhe kërkesave për qasje në informata me karakter publik që do të marrin përgjigje nga institucionet përgjegjëse.

Përgjithësisht, procedura për fitimin me automatizëm të shtetësisë për qytetarët pa shtetësi të cilët jetonin në territorin e vendit deri në shpalljen e pavarësisë po funksionon : secila lëndë që ka marrë epilog ka përfunduar me fitim të shtetësisë.

Megjithatë, mbetet shqetësues numri i lëndëve të prapambetura të cilat ende nuk janë trajtuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, me gati dy të tretat e lëndëve të prapambetura që janë më të vjetra se 10 muaj, gjë që ngelet e pasqarueshme dhe e

pajustificueshme duke marrë parasysh se në këto lëndë nuk është i nevojshëm opinion i Agjencisë për Siguri Nacionale.

Andaj, Kuvendi por edhe mediat dhe shoqëria civile duhet të rrisin presionin mbi Ministrinë e Punëve të Brendshme për të zbatuar ligjin sipas dispozitave në fuqi.

Ministria e Punëve të Brendshme duhet të trajtojë aplikimet sipas procedurës së nenit 7 të Ligjit për shtetësi brenda një afati të arsyeshëm ligjor, me automatizëm dhe pa pengesa e vonesa të paarsyeshme.

Ministria e Punëve të Brendshme duhet gjithashtu të sigurojë transparencë të plotë rreth aplikimeve për shtetësi, përfshirë duke u mundësuar aplikuesve që të ndjekin progresin e lëndës së tyre përmes infrastrukturës informatike të ministrisë.

Kontakt

Instituti për Politika Publike
Arbën Xhaferi
E-mail: info@ipp-arbenxhaferi.org
Tel: +389 2 522 2922
Web: www.ipp-arbenxhaferi.org
Rruga Dame Gruev 7/8/3
1000 Shkup
Maqedonia e Veriut

